

Rëndësia dhe urtësia e adhurimit



Nga Mustafa Tërniqi

Falënderimet i takojnë Allahut Fuqplotë, i cili na krijoi dhe e përsosi krijimin tonë, na furnizon në çdo moment, edhe pse me gabimet e mëkatet tona nuk e meritojmë, ndërkohë mirësitë e Allahut tek ne janë aq shumë sa s'mundemi kurrë t'i numërojmë. Allahu i Madhëruar nuk e krijoi njeriun pa qëllim, por e krijoi atë që të njohë Zotin e Vet, ta falënderojë e ta adhurojë Atë. Allahu i Lartësuar në Kuranin Famëllartë thotë: **“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, por vetëm që të më adhurojnë Mua”**. Dharijatë 56.

Në qoftë se dikush do të na bënte një nder, do të na ndihmonte në një punë apo do të na gjendej pranë në problemet dhe ngushticat e jetës sonë të përditshme do të ishte mosmirënjohje po të mos e falënderonim atë. Ndërsa fisnikëri e vërtetë do të ishte atëherë kur do të mundoheshim t'ia shpërblenim. Po me atë që na krijoi, na përsosi e na furnizoi: a nuk duhet të jemi gjithmonë mirënjohës? Allahu na dha jetën, arsyen, shqisat, e mirësi të vazhdueshme brenda dhe jashtë vetes sonë, si dhe na dalloj nga kafshët e na lartësoi ndaj shumë prej krijesave të tjera. Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëllartë thotë: **“Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëronit dot.”** Ibrahim 34.

Njeriu duhet t'i jetë mirënjohës Zotit për të gjitha mirësitë, e ta falënderojë Atë mëngjes dhe mbrëmje. Andaj dhe falënderimi i Allahut quhet adhurim, jo veç për faktin se na ka dhënë aq shumë mirësi, por edhe sepse ai është Krijuesi

ynë e ne jemi robërit e Tij. Allahu i Madhëruar na e ka bërë obligim ta adhurojmë Atë në forma të ndryshme, në mënyrë që t'i jemi mirënjohës Atij me të gjithë qenien tonë. Njeriu e madhëron dhe e adhuron Allahun me gjymtyrët e tij nëpërmjet namazit, me brendësinë e tij nëpërmjet agjërimit, me pasurinë e tij nëpërmjet zekatit dhe me sakrificën e tij nëpërmjet haxhit. Këto adhurime me në krye namazin nuk janë mbinkarkesë për njeriun, sepse Allahu i Urtë e i Gjithëdijshëm nuk i ngarkon krijesat përtej mundësisë së tyre, që ata kanë. Përkundrazi Allahu kërkon nga ne shumë më pak nga ajo që kemi mundësi të bëjmë. Ndërkohë na mëshiron me mëshirën e Tij të gjerë, edhe pse nuk e meritojmë atë mëshirë të madhe me punët e pakta që bëjmë.

Të gjitha obligimet dhe adhurimet në Islam kanë ardhur në dobi të njeriut, sepse Allahu nuk ka nevojë për adhurimet tona, por jemi ne ata që kemi nevojë në çdo moment për Zotin tonë, i cili meriton të adhurohet në çdo moment. Namazi për shembull e përmirëson njeriun nga ana e disiplinës me veten e tij, por dhe në marrëdhënie me njerëzit e tjerë. Ndërsa Zekati, ky adhurim dhe obligim i veçantë rregullon dukshëm problemet sociale të njerëzve. Zekati lufton varfërinë, shërben në uljen e papunësisë, rrit mirëqenien e njerëzve, largon armiqësinë dhe zilinë nga zemrat e nevojtarëve, si dhe rrit unitetin, solidaritetin dhe humanizmin. Zekati forcon vëllazërinë dhe ul ndjeshëm praninë e vjedhjeve, grabitjeve, mashtrimeve dhe krimeve në përgjithësi. Kurse agjërimi është një adhurim që ka dobi fetare, morale, sociale dhe shëndetësore. Agjërimi

është një adhurim i veçantë që përzien mes devotshmërisë dhe përsosjes morale, e cila manifestohet nëpërmjet sakrificës, durimit, mëshirës, bujarisë etj. Agjërimi e forcon më shumë besimtarin në sinqeritetin e tij ndaj Allahut, e bën atë më të durueshëm nga uria dhe etja që të forcohet e kalitet më shumë për sprovat e jetës. Agjërimi e bën besimtarin të mendojë më shumë praktikisht për njerëzit e varfër, të cilët uriten dhe eten. Agjërimi e pastron besimtarin nga veset e liga dhe e nxit besimtarin të ndihet më afër me besimtarët e tjerë. E për sa i përket haxhit, këtij adhurimi tepër madhështor, shikojmë se ai është me të vërtetë një institucion i vërtetë edukimi shpirtëror dhe fizik me vlera të larta shoqërore. Me kryerjen e këtij riti fetar kurohen

sëmundjet shkatërruese të zemrës. Aty fitohet durimi, përkushtimi, vëllazërimi, solidariteti, toleranca, mëshira dhe mbi të gjitha, barazia mes njerëzve.

Nga të gjitha obligimet dhe adhurimet e Fesë Islame namazi është adhurimi më i rëndësishëm pasi ai kryhet pesë herë në ditë, prandaj dhe shikojmë se Profeti Muhamed (alejhissalatu uesselam) i ka kushtuar namazit një rëndësi tepër të veçantë dhe e ka quajtur “Shtylla e fesë”. Namazi është adhurimi që e karikon muslimanin plot energji besimi, e forcon atë në fenë e tij dhe e ndihmon që të bëjë një jetë islame të rregullt. Kjo sepse namazi me pesë kohët e tij e bën besimtarin ta kujtojë Allahun e Madhëruar mëngjes e mbrëmje, natën dhe ditën. Me fjalë të tjera, namazi është adhurimi që e mban njeriun të lidhur me Zotin që e krijoi. Përveç kësaj namazi e bën njeriun të urtë, njerëzor dhe të dobishëm për shoqërinë. Namazi është rregullator i përkryer i jetës së njeriut, është ilaç për zemrën dhe ushqim për mendjen.

Në të vërtetë ky adhurim është mëshirë e Allahut për robërit e Tij, sepse në dynja njeriu nëpërmjet këtij adhurimi ruan besimin e tij dhe në Ditën e Gjykimit do t'i lehtësohet llogaria, kur të dalë para Allahut të Plotfuqishëm. I Dërguari i Allahut (alejhissalatu uesselam) ka thënë: **“Vepra e parë për të cilën do të japë llogari njeriu Ditën e Gjykimit është namazi. Në qoftë se njeriu është i rregullt me namazin do të jetë i shpëtuar, e nëse nuk do të jetë në rregull me të, atëherë do të jetë i shkatërruar.”** Transmetuan Tirmidhiu dhe Nesaiu. Në një version tjetër që e shënon Taberaniu thuhet: **“Në qoftë se llogaria e namazit do të dalë mirë do jetë më e lehtë për të në punët e tjera, e nëse llogaria e namazit nuk del mirë, atëherë prishen dhe punët në vazhdim.”**

Fq 3 / Bindje e plotë ndaj asaj që Allahu ka urdhëruar

Nga Qazim Selimaj

Fq 4 / Satira politike e Hafiz Ibrahim Dallit në poemën “Dokrrat e Hinit”

Nga Petrit Kusi

Fq 6 / Roli i parimeve Islame në ruajtjen e pasurisë publike

Fq 7 / Identitetet përthyeset e mesazhit

Nga Gazmend Leçini

Fetva / Rregullat e zbulimi të vendeve të turpshme gjatë kurimit

Lavdia i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka profet tjetër, për familjen dhe shokët e tij. Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam, pranë Ligës së Botës Islame, në Sesioni e saj të katërbëdhjetë të mbajtur në Mekën e nderuar në datën 20 Shaban 1415/ 21 Janar 1995 shqyrtoi temën e mësipërme dhe vendosi:

1- Norma islame bazë thotë se: Nuk lejohet që gruaja t'i zbulojë një burri pjesët e turpshme të trupit (auretin) të saj dhe as anasjelltas, as gruaja para gruas dhe as burri para burrit.

2- Asambleja konfirmon vendimin e dalë nga Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam pranë Organizatës së Konferencës Islamike me nr. 85/12/85 më datë 1-7/ 1/1414, ku thuhet tekstualisht: "Si normë bazë vlen rregulli: nëse brenda mundësive gjendet një mjeke specialiste muslimane, atëherë ajo duhet të kryejë ekzaminimin e të sëmurës dhe kontrollin e saj. Nëse nuk gjendet një mjeke muslimane, atëherë rolin e saj mund ta kryejë një mjeke jomuslimane. Nëse nuk gjendet një e tillë, atëherë këtë detyrë e kryen një mjek musliman dhe nëse nuk gjendet një i tillë, atëherë detyrën e tij mund ta kryejë një mjek jomusliman, por me kusht që të kontrollojë dhe të vizitojë trupin e gruas vetëm sipas nevojës për të ekzaminuar dhe për të përcaktuar mjekimin e sëmundjes pa e tejkaluar cakun e nevojshëm dhe duke e kufizuar shikimin sa të mundet. Gjithashtu kontrolli i mjekësor për gruan duhet të bëhet në prani të një mahremi (të afërmi familjar), ose në prani të bashkëshortit apo të një gruaje të besueshme, për të mos qenë të vetmuar."

3- Në çfarë do rasti, nuk lejohet pjesëmarrja e dikujt tjetër bashkë me mjekun, vetëm sipas masës që dikton nevoja. Mjekët që merren me këtë ekzaminim duhet të respektojnë privatësinë dhe sekretet e pacientes, nëse ka të tilla.

4- Njerëzit përgjegjës për shëndetin dhe spitalet duhet të jenë të kujdesshëm për të ruajtur privatësinë dhe intimitetin e muslimanëve dhe myslimanëve, duke vendosur norma dhe rregullore orientuese të posaçme, që përmbushin këtë qëllim dhe që ndëshkojnë këdo që nuk i përmbahet etikës islame dhe rregullave të larta të mirësjelljes dhe duke siguruar të gjitha mjetet që përmbushin mbulimin e vendeve intime dhe moszbulimin e tyre gjatë operacioneve, vetëm në rastet kur e dikton nevoja dhe brenda hapësirës së domosdoshme, duke dhe përdorur për këtë gjë veshje të përshtatshme fetarisht.

5- Asambleja ndër të tjera këshillon sa vijon:

a- Njerëzit përgjegjës të shëndetësisë duhet të përshtatin politikën e tyre shëndetësore me parimet dhe praktikën e fesë sonë Islame dhe sipas normave të larta etike. Të tregojnë kujdes të plotë për të mos vënë në pozitë të vështirë muslimanët, për të ruajtur dinjitetin dhe nderin e tyre.

b- Të punohet për të siguruar nëpër spitale, një punonjës që të shërbejë si udhëzues fetar në mënyrë që të udhëzojë dhe të këshillojë të sëmurët.

Paqja dhe Bekimi i Allahut qoftë për Profetin tonë Muhamed, për familjen dhe shokët e tij.

Burimi: <http://www.themowl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=142&l=AR&cid=16>

Fetva / Sëmundjet e trashëguara të gjakut

Lavdia i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka profet tjetër, për familjen dhe shokët e tij. Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam me qendër në Mekë, që zhvillon aktivitetin e tij nën kujdesin e Organizatës së Ligës së Botës Islame, në sesionin e saj të shtatëmbëdhjetë të zhvilluar në Mekën e nderuar, në periudhën ndërmjet 19-23 Sheval 1428 h. (13-17/12-2003) shqyrtoi temën "Sëmundjet e trashëguara të gjakut" dhe sa legjitime është detyrimi i për të kryer analizat mjekësore për ata që dëshirojnë të martohen. Pas dëgjimit të studimeve të paraqitura dhe diskutimeve nga ana e anëtarëve dhe specialistëve për këtë çështje Asambleja vendosi:

Së pari: Akti i martesës bën pjesë në ato akte ku kriteret dhe pasojat ligjore të saj janë vendosur nga vetë Ligjvënësi i Madhëruar, ndaj hapja e kësaj dëre, duke shtuar diçka mbi ligjin islam, siç është detyrimi për të kryer analizat mjekësore para martesës dhe lidhja e zyrtarizimit të këtij akti martesor me këtë kusht, është një veprim që nuk lejohet.

Së dyti: Akademia këshillon qeveritë dhe institucionet islame, që të ndërtojë një njerëzit për rëndësinë e kryerjes së kontrolleve mjekësore para martesë, që të nxisin popullatën për ta bërë diçka të tillë, të lehtësojnë procedurat e këtyre kontrolleve, për njerëzit që dëshirojnë t'i kryejnë ato dhe që t'i realizojnë ato në mënyrë të fshehtë, duke mos ia treguar rezultatet e këtyre kontrolleve dikujt tjetër përveç atyre që kanë të bëjnë me to në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Burimi: <http://www.themowl.com/Bodies/Researches/default.aspx?d=1&rid=99&l=AR>

Fetva / A lejohet balsamosja me qëllim mësimi dhe praktike?

Pyetja: A lejohet balsamosja me qëllim mësimi dhe praktike?

Përgjigja: Së pari duhet thënë se çdo krijesë e gjallë një ditë do të vdesë dhe askush nuk bën përjashtim nga ky ligj i Zotit. Allahu thotë për këtë gjë në Kuran: "Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne." (Ankebut: 57).

Së dyti, sipas normave të fesë islame, çdo njeri që vdes duhet të varroset dhe çdo kafshë që ngordh duhet të groposet. Allahu duke treguar sesi u varros njeriu i parë në këtë botë thotë: "Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit. Allahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t'i treguar sesi ta mbulonte kufomën e të vëllait." (Maide: 30-31).

-Për sa i përket balsamosjes, ajo e thyen këtë normë, për këtë dhe në origjinë nuk lejohet balsamosja dhe ruajtja e trupave të vdekur apo të ngordhur.

-Përjashtim nga ky rregull bëjnë rastet kur balsamosja është e domosdoshme apo e nevojshme, sipas këndvështrimit islam, siç mund të jetë p.sh: nevoja mësimore.

-Për sa i përket trupave të njerëzve, balsamosja e tyre nuk lejohet, pasi -me aq sa dimë- asnjë domosdoshmëri apo nevojë - sipas këndvështrimit islam- nuk ka në këtë rast. Po kështu procesi i balsamosjes shoqërohet me gjymtimin e organeve të trupit dhe kjo është një arsye më vete pse nuk lejohet balsamosja e trupit të njeriut, pasi feja islame e ndalon gjymtimin e kufomës, edhe nëse ai nuk është musliman. Veç kësaj mund të shtojmë se balsamosja e njerëzve është traditë e disa popujve idhujtarë, siç ishin egjiptianët e lashtë, dhe bëhej për shkak të besimeve të tyre të kota.

- Për sa i përket balsamosjes së kafshëve mendojmë se:

1- Lejohet nëse bëhet vetëm për arsye studimi, me kusht që të mos tepruhet në këtë drejtim, si në kohën apo shpenzimet që merr kjo punë.

2- Lejohet për arsyen e mësipërme, sepse nuk ka ndonjë argument të drejtpërdrejtë fetar që e ndalon apo e lejon atë dhe si argument bazë në këtë drejtim qëndron rregulli që thotë, se diçka e cila nuk ka të bëjë me adhurimet është e lejuar, përderisa nuk ka asnjë argument që ta ndalojë atë.

3- Lejohet sepse kafsha e balsamosur nuk i ngjan statujave, pasi ajo nuk është përngjasim i krijesës së Allahut, por është vetë krijimi i Tij.

4- Ndërsa balsamosja e kafshëve për qëllime zbulimi ne mendojmë se është e papëlqyeshme, sepse krijon imazhin e një statuje, të cilat nuk lejohen në Islam, edhe pse kafsha e balsamosur nuk është e tillë. Allahu e di më së miri.

Njohje me Akademinë Ndërkombëtare të Jurisprudencës Islame

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut (jursiprudencës) Islam është themeluar në zbatim të rezolutës të nxjerrë në Samitin e Tretë të Vendeve të Konferencës Islamike të mbajtur në Mekë, në 19-22 Rabiul euel 1401. H (25-28 janar 1981), e cila thotë:

"Krijimi i një akademie të quajtur: "Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam", anëtarë të së cilës do të jenë juristë islamë, dijetarë dhe mendimtarëve të fushave të ndryshme: të dijës ligjore islame, kulturore, shkencore dhe ekonomike, nga e gjithë bota islame. Qëllimi i kësaj akademie është të studiojë problemet e jetës bashkëkohore dhe të përpiqet akademikisht, bazuar në parimet e pandryshueshme të fesë islame, të parashtrorë zgjidhje që burojnë nga trashëgimia islame dhe po ashtu të jetë e hapur karshi prurjeve të evoluimit të mendimit islam."

Nisur nga fryma e kumtit që Meka përçon, Organizata e Konferencës Islamike plotësoi një sërë procedurash ligjore dhe ekzekutive për zhvillimin e kornizës ligjore dhe administrative për të përmbushur atë që kërkuan udhëheqësit myslimanë, për krijimin e një akademie të jurisprudencës islame, e cila mbledh së bashku studiuesit e Umetit Islam, për t'i dhënë përgjigje dhe zgjidhje origjinale të përshtatshme çdo pyetje që parashtrorë zhvillimet e jetës bashkëkohore.

Adresa e Faqes zyrtare të Akademisë: <http://www.fiqhacademy.org.sa/>

Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:
Justinian Topulli
Genc Plumbi
Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës
Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Oazi i shpirtit / Bindje e plotë ndaj asaj që Allahu ka urdhëruar

Nga Qazim Selimaj

Mendoj se ndodhi të tilla të jashtëzakonshme kanë ndikim shpirtëror te çdo individ. Ato prekin zemrën e çdo besimtari, pa marrë parasysh pozitën e tij në të cilën ai ndodhet. Në këtë tregim bëhet fjalë për të kaluarën e ndritur të të parëve tanë, gjurmët e së cilës janë skalitur në historinë islame dhe është vështirë të harrohen, edhe pse koha ecën dhe shekujt kalojnë. Shenjat e tyre mbeten të qarta dhe të freskëta edhe në ditët e sotme, sepse veprat e tyre mbështeteshin tek Kurani, kushtetuta hyjnore, dhe Suneti profetik. Përkushtimi dhe vepra e tyre mbetet argument i qartë për besimtarët e sotshëm, të cilëve ua kujton origjinën e Islamit, si dhe peshën dhe rëndësinë e besimit të të parëve tanë.

Muslimanët e asaj kohe udhëhiqeshin nga persona, që jetonin me librin e Allahut, morali i të cilëve modelohej me atë të Profetit a.s., për të cilin Allahu në Kurani e Shenjtë na thotë, se ai ishte me një moral të lartë, si dhe shembulli më i mirë për ne dhe për mbarë njerëzimin. I tillë ishte udhëheqësi i drejtë i muslimanëve "Faruku", për të cilin Profeti a.s. ka thënë se: "shejtani ndërron rrugë kur shikon Omerin." Devotshmëria e tij ishte e jashtëzakonshme, personaliteti dhe drejtësia me njerëzit e bënte atë që të ishte i respektuar dhe i dashur për mbarë zemrat e besimtarëve muslimanë dhe të krishterë. Por ku qëndronte sekretet për një dashuri të tillë në mesin e njerëzve? Me pak fjalë do të thosha: respektimi i dispozitave dhe gjykimi në bazë të librit të Allahut, pa dallim shtresash e bënë atë që të meritonte edhe gradën faruk, dallues i së drejtës nga e shtrembëra. Tani të shohim se çfarë thotë tregimi, i cili zgjoi tek unë një ndjenjë të brendshme, për të reaguar dhe për t'u kujtuar personave në detyrë, se dashuria e njerëzve fitohet nëpërmjet drejtësisë, sinqeritetit dhe devotshmërisë.

Një ditë ndërsa Kalifi Omer bin Hatabi r.a. ishte në shoqëri të sahabëve erdhën dy djelmosha duke sjellë para tyre një beduin (fshatar). Posa u paraqitën tek Omeri, ai i pyeti: "Çfarë do të thotë kjo?"- Ata thanë: "Ky njeri ka vlarë atin tonë."- A e ke vlarë atin e tyre?- e pyeti Omeri. "Po."- u përgjigj beduini. "Si e vlarë?- e pyeti Kalifi. Beduini iu përgjigj: "Hyri me devetë e tij në tokën time. Unë i tërhoqa vërejtjen, por ai nuk ua vuri veshin fjalëve të mia, dhe hodha një gur mbi të. Guri e goditi në kokë dhe ai vdiq."

Omeri r.a. tha: "Gjykimi për të është vdekje". Urdhri sipas dispozitave të shariatit nuk pranon diskutim. Omeri nuk pyeti për familjen e këtij njeriu. Ai nuk u interesua fare, se a ishte nga familje me nam, e fuqishme, e madhe dhe çfarë pozite kishte në shoqëri. Omerit asgjë nga këto nuk i interesonte, sepse ishte i drejtë në gjykim me ligjin e Allahut. Sikur të ishte në këtë rast edhe i biri, ai do t'i jepte të njëjtin dënim. Njeriu që do të dënohej i tha: "O udhëheqës i besimtarëve, të lutem në emër të Atij që krijoi qiejt dhe tokën, të më liroshe vetëm një natë. Dëshiroj të shkoj te familja ime, bashkëshortja dhe fëmijët në shkretëtirë. Dëshiroj t'i njoftoj se do të më dënosh. Pastaj do të kthehem. Beto hem në Allahun, se përveç Allahut nuk kanë

askënd veç meje."- Omeri r.a. tha: "Kush garanton për ty që do të kthehesh?"- Të gjithë njerëzit heshtën. Atje beduinin nuk e njihje askush. Nuk e dinin as ku jetonte, ku e kishte tendën, e as cilit fis i takonte. Si mund të garantonte dikush për të, kur kjo garanci ishte me jetë. Kush do t'i kundërvijehj Omerit në aplikimin e ligjit të Allahut, nëse beduini nuk kthehej? Kush ishte ai që të ndërmjetësonte për të? Sahabët heshtën. Omeri ndjeu një vështirësi dhe ishte në dilemë. Çfarë të bënte? A thua ta dënonte njeriun në fjalë dhe t'i linte fëmijët e tij të vdisnin nga uria? Apo ta lëshonte pa kurrfarë garancie, ndërkohë mund të humbiste haku i të vlarit? Njerëzit heshtën, ndërsa Omeri po hamendej dhe më pas u kthye kah djelmoshat duke i pyetur: "A po ia falni?-" "Jo!"- u përgjigjën djelmoshat. Omeri r.a. përsëri tha:

"Njerëz, kush jep garanci për këtë njeri?"- Ebu Dher el-Gifari u ngrit dhe ashtu plak përplot përulësi dhe sinqeritet tha: "O Udhëheqës i Besimtarëve, unë garantoj për këtë njeri."- Omeri i tha: "Ky është vrasës."- Ndërsa Ebu Dheri tha: "Po, edhe pse është vrasës."- Omeri e pyeti: "A e njeh?"- Ebu Dheri tha: "Jo."- Omeri përsëri e pyeti: "Si do të garantosh për këtë?"- Ebu Dheri shtoi: "Vërejtja në fytyrën e tij shenjat e besimtarit. Kuptova që nuk po gënjen dhe inshallah do të kthehet."- Omeri tha: "Ebu Dher, mos mendo se do të lëshoj, nëse nuk kthehet brenda tri ditëve!"- Ebu Dheri tha: "Allahu është i vetmi Ndihmues, o Udhëheqës i Besimtarëve."- Omeri e lëshoi këtë njeri të shkojë në shtëpi dhe të përgatitet, të përshëndetet me gruan dhe fëmijët e tij, e pastaj të kthehet. Omeri nuk e harroi kohën e marrëveshjes dhe numëronte çdo ditë. Ditën e tretë në kohën e pasdrekës tellalli thirri njerëzit. Populli së bashku me dy djelmoshat e babait të vlarë u mbledhën aty. Ebu Dheri qëndronte pranë Omerit r.a., ndërsa Ai e pyeti: "Ku është njeriu?"- Ebu Dheri u përgjigj: "Nuk e di, o Udhëheqës i Besimtarëve!"

Sahabët heshtnin, ndienin vështirësi për të cilën askush nuk e dinte përveç Allahut xh.sh. Është e vërtetë që Ebu Dheri ishte ngulitur thellë në zemrën e Omerit dhe e dinte që do të jepte çdo gjë për të, por këto janë ligjet e Zotit dhe askush nuk kishte të drejtë të luajë me këto rregulla.

Pak para se të perëndojë dielli, njeriu u paraqit. Omeri bëri tekbir, po ashtu edhe muslimanët e tjerë. Omeri tha: "O njeri, sikur të mbeteshe në shkretëtirë, nuk do të dinim për ty, as vendin ku jeton."- Ai iu përgjigj: "O Udhëheqës i Besimtarëve! Për Allahun, unë nuk frikësohem nga ti, por nga Ai i cili di të fshehtë dhe të dukshmen. Ja, o Udhëheqës i Besimtarëve, unë e lashë bashkëshorten dhe fëmijët në mes shkretëtirës pa ujë dhe pa asnjë thërrime buke, erdha që të ekzekutohet mbi mua urdhri për vrasje. Kisha frikë se mos do të thotë dikush në mes njerëzve, se e theva premtimin." Omeri e pyeti Ebu Dherin:

"Përse dhe garanci për të?"- Ebu Dheri tha: "Kisha frikë se mos njerëzit thonë, se ka humbur mirësia në mesin e njerëzve."

Omeri r.a. u kthye kah djelmoshat dhe tha: "Çfarë mendoni ju?"- Ata duke qarë thanë: "Ja falim për sinqeritetin e tij, o Udhëheqës i Besimtarëve. Ne kemi frikë

se mos dikush thotë, se ka humbur falja në mesin e njerëzve. Omeri thirri: "Allahu Ekber",- ndërsa lotët lagnin mjekrën e tij, pastaj tha: "Allahu jua shpërbleftë për faljen tuaj, djelmosha. Allahu e shpërbleftë Ebu Dherin që e shpëtoi këtë njeri! Allahu e shpërbleftë beduinin për sinqeritetin e tij dhe për mbajtjen e premtimit!" Allahu e shpërbleftë Omerin për drejtësinë dhe dhembshurinë e tij!

Njëri prej dijetarëve ka thënë: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, lumturia e imanit dhe e Islamit është varrosur në qefinët e Omerit."

Kështu ishin të parët tanë, si besimtarët e thjeshtë, po ashtu edhe prijësit e tyre; ata jetuan me Islam, por kurrë nuk u privuan nga të drejtat e tyre, përkundrazi Islami i dha kuptim jetës dhe personalitetit të tyre. Omeri ndoshta nuk përsëritet më, por shembulli i tij duhet të përjetohet.

Ne duhet ta ndjejmë veten të privilegjuar, sepse Profeti a.s. na ka cilësuar vëllezër të tij, por si mund të jemi vëllezër duke mos qenë trashëgimtarë të asaj që quhet tradita profetike. Allahu xh. sh. nuk pranon, që me fuqinë e Tij të ndryshojë qenien e brendshme njerëzore, nëse vetë njeriu nuk synon realizimin dhe fitoren e Fjalës së Allahut.

Këtij qëllimi besimtari duhet t'i përkushtohet me tërë qenien, fuqinë, vullnetin dhe dijen e vetë. Sa e sa persona kanë sot ndjekësit e tyre, politikanë qofshin apo të tjerë, kudo shohim një militantizëm

të paparë dhe në të njëjtën kohë nuk dimë arsyen apo motivin, që i shtyn këto turma pasuesish.

Në Islam gjërat nuk veprohen sipas forcës së zakonit; ndjekja e Profetit dhe e njerëzve të mire është obligim. Në misionin Islam nuk ka vend mashtrimi, korrupsioni dhe falsitetet e tjera, të cilat shërbejnë si imazh ndaj të pavërtetës. Islami është sistem jetese dhe Krijuesi i Universit, i Cili na solli në këtë jetë e zbriti atë për t'i dhënë kuptim jetës tonë. Prandaj çdo punë false ka në krye të saj njerëz fals, çdo mashtrim bëhet nga mashtruesit, çdo e keqe vjen nga i keqi. Profeti a.s. ka thënë: "Gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta për besimtarët." Prandaj kushdo që e beson Allahun dhe Profetin e Tij nuk mund t'i shkelë këto dispozita.

Për t'i bërë një analizë gjendjes së sotme e kam shumë të vështirë, pasi gjendja jonë aktuale nuk përkon me rastin në fjalë, përse i përket sinqeritetit dhe devotshmërisë, madje është tejet e venitur në lidhje me shpirtin e pasinqertë, një shpirt ky i burgosur brenda mureve të kalasë njerëzore dhe i destinuar të vuaj dënimin e tij paraprak e më vonë atë në përjetësi.

Si përfundim mendoj, se do të ishte kënaqësi dhe në nderin e tyre, që udhëheqësit e sotëm t'i ngjajnë Omerit, për të qenë të dashur e të respektuar, së pari tek Allahu, e më pas tek besimtarët dhe aspak e dëshirueshme për një model të kundërt për të cilin zemrat prodhojnë vetëm urrejtje.

Të dua o Muhamed (salallahu alejhi ue selem)



Të dua, o ti që realitetin e kësaj fjale të bukur nga ty e mësova!

Mësova prej teje, se ëmbëlsinë e besimit do ta shijoj atëhere kur Allahun dhe ty (o i Dërguar i Zotit), t'ju dua më shumë se çdo gjë tjetër në këtë ekzistencë, madje edhe më shumë se vetveten.

Më mësove që prindërit t'i dua me një dashuri të veçantë dhe se ata me të vërtetë e meritojnë këtë dashuri; madje më mësove që kjo dashuri më çon në Xhenet.

Ti ishe, që më orientove që dashurinë ta kem sjelljen dhe virtytin tim në çdo aspekt, e nëse do ta dua dike, ta dua vetëm për hir të Allahut e jo për interesa të kësaj bote, sepse nëse dashuria është e tillë nuk zgjat shumë e as nuk jep fryte.

Ti më mësove që dashurinë ta kem të madhe, të mos ja kursej atë askujt, madje më tregove se nuk do të jem kurrë musliman i denjë, derisa të dua për muslimanët atë që dua për veten time.

Unë vërtet nuk qëndrova pranë teje, madje as nuk arrita dot të të shikoja, por prej teje unë mësova ç'është dashuria.

Ishe pikërisht ti ai që më mësove, se dashuria reale është ajo e cila ka vend për jetimët, të vejat, fukarenjtë e nevojtarët. E pra ti më vizatove kufijtë e dashurisë në zemrën time.

Kështu që unë do të të dua ty, që më mësove dashurinë. Do të të dua, sepse ti dashurinë tënde nuk e kurseve për askënd, madje as për ne që kemi ardhur shumë më vonë pas vdekjes tënde.

Ditën më të vështirë për njerëzimin. Atë ditë kur ata të jenë paraqitur të gjithë para Zotit të tyre, kokë ulur, pa fjalë e të frikësuar -ndërkohë që presin gjykimin-, ti do të kërkosh leje e pasi Allahu ta japë këtë mundësi do të thuash: -O Allah! Shpëtoje umetin tim (shpëtoji besimtarët). E kjo tregon dashurinë tënde të madhe, e cila nuk njeh kufi.

Do të të dua o Muhamed dhe dashurinë që kam për ty kurrë nuk do të më zbehet, edhe pse dikush përpiqet ta fikë atë në zemrat e besimtarëve.

Do të të dua deri në frymën e fundit, dhe lus Allahun, që këtë dashuri të më ndihmoj ta ve në zbatim me mësimet, këshillat dhe ato që ti ke urdhëruar.

Do të të dua, sepse ti mëshirë u dërgove për të gjithë njerëzimin, dhe me dashurinë tënde i fitove zemrat e tyre.

O Zot, na tako me Profetin tonë ditën e Gjykimit, e na ringjall në shoqërinë e tij, e na bashko me të në Xhenet. AMIN.

Bledar Haxhiu

Histori / Satira politike e Hafiz Ibrahim Dalliu në poemën “Dokrrat e Hinit”

Nga Petrit Kusi

Hafiz Ibrahim Dalliu përveç të tjerash është shquar si poet satirik. Kjo veti e tij duket në veprat e rëndësishme: “Grenzat e kuqe të Tiranës”, botuar më 1915 dhe “Dokrrat e Hinit”, botuar më 1922. Vetë titulli “Dokrrat e Hinit” është tepër stigmatizues. Autori vë në lojë ata njerëz që nuk i bënin asnjë shërbim Atdheut e kombit, por e kalonin kohën me thashetheme e me llafe të padobishme nëpër kafenetë e ndyra të Tiranës.

Vitet 1920-1925 shënojnë luftën dhe përpjekjet e Shqiptarëve për t'i dhënë Shqipërisë fizionominë e një shteti politik, i cili edhe pas Shpalljes së Pavarësisë më 1912, ende nuk e kishte marrë formën e tij të plotë, edhe për faktin se gjatë Luftës së Parë Botërore ishte bërë shesh lufte i Fuqive të Mëdha. Në kontradiktat mes Demokratëve dhe Bejlerëve në vitet 1920-1924, dihet se Dalliu ka mbajtur gjithmonë anën e Demokratëve. Pikërisht nga kjo pozitë ai dënonte me forcë gjithë ata që kishin mendime të mykura dhe e kërkonin shpëtimin e kombit nga Turqia. Por Dalliu godiste ashpër edhe ata intelektualë e pseudo-patriotë, të cilët hiqeshin si modernë dhe mohonin traditat e mira dhe mënyrën e thjeshtë të jetesës së popullit. Ai godiste ashpër ata intelektualë, që kishin mësuar nëpër shkollat të huaja dhe që kishin prirje për përfitime vetiake, për ryshfete e që komprometoheshin lehtë.

Në poemën “Dokrrat e Hinit” poeti sjell mesazhin, se pa punë nuk mund të përparojë vendi, nuk mund të zhvillohet ekonomia dhe se një vend me ekonomi të dobët është i destinuar t'i nënshtrohet të huajit.

Krahas punës Dalliu kërkon që Shqiptarët të fitojnë edhe dituri. Në këtë vështrim ai mund të quhet, si vazhdues i mendimit dhe i ideve kombëtare të Rilindasve të mëdhenj. Ja si shkruan ai në fillim të poemës:

Duhet punë me mend në krye
N'daçim njerëzisht me rrue gjallë,
Se, përndryshe, s'bëhet pallë,
Tue ndenjün kot me sy ndry.
Duhet punë po, natë e ditë,
Se jemi në të njëzetin shekull.
Edhe t'punojmë fort me rregull,
N'daçim me pa pakës dritë.

Këtu është rasti të kujtojmë Naim Frashërin me vargjet:

Punë, punë, natë e ditë
Që të shohim pakëz dritë.

Në poemën “Dokrra Hini” Dalliu ngre edhe çështjen e mërgimit. Shqiptarët e donin punën, por ngaqë në Shqipëri s'kishte industri ata ishin të detyruar të shkonin për të gjetur punë në Amerikë dhe në vise të tjera.

Ç'të bënin shqiptarët e gjorë, që s'kishin mundësi të shkonin në kurbet? Poeti thekson se ata rrinin gjithë ditën nëpër kafenetë e Tiranës, ku çdo gjë nxinte nga tymi. Aty luhej “kumar e tavlla”. S'kishte mjedise të kulturuar, s'kishte gazeta... Klientët uleshin nëpër stola ose hasra. Nuk kishte as tryeza. Mungonte krejtësisht pastërtia. Edhe kafetë e limonadat nuk ishin fare të shijshme. Në këto mjedise njerëzit argëtoheshin me dokrra pa bukë e pa kuptim. Poeti gjen rastin të na përshkruajë disa nga këto kafene, si: atë të Lokes, të Ba-

rushit, të Lam Murthit etj., por kamera e poetit ndalet më gjatë te kafeneja e Hasan Bërshekut. Ndonëse më e ndyra ndër kafenetë e Tiranës, me një pronar nervoz e të pasjellshëm, fare pa kulturë e pa edukatë, ajo priste e përcillte klientët të moshave të ndryshme. Bisedat silleshin rreth politikës. Klienti Zym Veshi e ca të tjerë predikonin që në Shqipëri të vinte përsëri Turqia, se Shqipëria nuk mund të ecte përpara pa Turqinë. Kishte të tillë klientë, të cilët mendonin se përpara Turqisë do të përleshin edhe Anglia, edhe Franca; se në Shqipëri, në Shkodër, do të shkelte çizmja e Enver Pashës. Por kundër këtyre me mendime prej shqiptari, atdhetari dilte një plak nëntëdhjetëvjeçar, i cili hynte qetësisht e pa u ndier në kafene, ulëj në një qoshe e pastaj, natyrshëm përzihej në biseda. Ky ishte xha Sula, i cili ishte i bindur se shqipja do të fitonte, se Turqia nuk mund të shkelte përsëri në Shqipëri, se Shqiptarët po bëheshin të ndërgjegjshëm për të çuar përpara kombin e tyre. Xha Sula sillte argumente të forta kundër Zym Veshit me shokë, për t'i bindur ata se shqipja do të fitonte dhe se Shqipëria do të bëhej. Por xha Sula, si atdhetar i kulluar, nuk i duronte dot ata lloj patriotësh, të cilët mbanin papijon e xhaketa, kapele gyp, e kur flisnin, përdornin fjalë të huaja në vend të fjalëve shqipe. Xha Sula ishte për ruajtjen e traditave të vjetra të popullit.

Ja, si i vë në lojë poeti nëpërmjet gojës së xha Sulës, të gjithë ata pseudo-patriotë e pseudo-intelektualë, të cilët përdornin pa vend fjalë të huaja:

Ja, për t'qejtë inteligjenca,
Flasin disa fjalë të gjata,
Cirkostanca, situata,
Konferenca, konkurrenca,
Proponim, komunikatë,
Hyjnia, epopeja
Q'i t'bajnë me thanë: Mre kukeja,
A kështu ka pas fol yt atë?
Ku asht shqipe kjo gjuhë dreqi?
Ç'janë këto fjalë nga nji hapa-shalë?

Lidhur me strukturën e poemës, themi se poeti parapëlqen të përdorë vargun tetërrrokësh. Shumica e vargjeve kanë rimë të kryqëzuar, me skema ab-ba, por ka edhe vargje me rimë të ndërruar me skemë ab-ab. Poeti përdor dendur epitetin, për të cilësuar portretet e personazheve e të përshkruajë mjediset e kafe-haneve, p.sh.: Hasan Bërshekut e karakterizon xhinhy, hardallos, xhindos. Përdor shumë edhe hiperbolën, p.sh.: për Hasanin që të trembte me pamjen e tij thotë: “Bubuja, po m'ha me sy”. Përdor krahasimin, p.sh.: “Këta bajnë kafe me erë, çajna si lang kambsh” etj. Në poemë dallojmë kontrastin dhe antitezën, p.sh.: mendimet e kundërta të Zym Veshit e të xha Sulës. Ashtu si në shkrimet e tjera, edhe në këtë poemë, Dalliu përdor të folmen e Shqipërisë së Mesme. Me poemat e tij satiriko-poetike, si ndjekës i Rilindasve, ai mund të radhitet pa droje krahas Çajupit, Nolit e Fishtës.

Marrë nga: Hafiz Ibrahim Dalliu, *Vepra Letrare, Botime Enciklopedike, Tiranë 2000.*

Hafiz Dalliu & Gazeta Dajti

“...Përderisa në vendin tonë do të dominojnë e do të administrojnë njerëz që nuk kanë menduar në të mirë të Atdheut, unë do të jem në opozitë...”

- Hafiz Ibrahim Dalliu.

Nga Roald A. Hysa



Dalja e gazetës Dajti ka qenë një ngjarje e rëndësishme për kohën. Kjo gazetë ka luajtur një rol të ndjeshëm asokohe, duke u përpjekur të sjellë një zë të ri të fuqishëm në ato momente vështrësish politike për shtetin e sapokrijuar shqiptar. Hafiz Dalliu është

një ndër ato figura patriotësh tiranas të pastudiuara ende dhe të panjohura siç duhet nga pikëpamja e veprimtarisë së tij politiko-atdhetare. Hafizi është një nga ata burra që luftuan “me pushkë e penë për mëmëdhënë”. Ai e shkriu jetën e tij që ta ndriçonte popullin dhe atdheun nëpërmjet arsimit, përhapjes së diturisë dhe dashurisë ndaj atdheut. Ai ka dhënë një kontribut të ndjeshëm në fushën e politikës në disa drejtime. Pas ngritjes së Shtetit Independent ai ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet për deputet më 1923 dhe gjatë kësaj kohe ai nxirrte gazetën Xhoka, dhe përfaqësoheshin me partinë me të njëjtin emër së bashku me Jusuf Bankën. Menjëherë pas këtyre ngjarjeve në janar të 1924 ai fillon botimin e gazetës Dajti, ku kthehet në zëdhënësin e popullit të thjeshtë. Ai përsëri merr pjesë në zgjedhjet për kryebashkiakun e Tiranës në vitin 1925 dhe del i katërti me 976 vota. Ai falënderon publikisht tiranasit nëpërmjet gazetës për besimin që i dhanë me votat e tyre. Ishte një burrë me karakter të fortë, por edhe me shumë humor me të cilin nuk linte njeri pa thumbuar me rreshtat e “Dajtit në gaz”, apo edhe në vargjet që i qarkullonte gojari në popull. Madje ka pasur thumbime edhe me Gjergj Fishtë, i cili e respektonte maksimalisht Hafizin. Kjo gazetë trajtonte të gjitha çështjet e aktualitetit, si të gjitha gazetat e sotme moderne nëpërmjet rubrikave të ndryshme, ekonomike, lajme nga vendi dhe nga bota, politikë, sporti etj. Zakonisht shkrimi i faqes së parë i përket aktualitetit politik. Po në faqen e parë një kolonë e posaçme i kushtohet rubrikës “Dajti në gaz”, e cila i përket gjinisë së fejtimit dhe është mbajtur vazhdimisht nga vetë Hafiz Dalliu. Në faqet e dytë ka lajme të ndryshme nga kronika e zezë, ekonomia, reklama e njoftime. Në faqet e kësaj gazete është diskutuar edhe për formën e regjimit, e cila në ato çaste nuk ishte zgjidhur akoma dhe vendi drejtohej nga Regjenca prej katër anëtarësh. “Monarkia a po Republikë?” është një shkrim i faqes së parë nga H. Jusuf Banka ku më pas diskutimi vazhdon në numrin vijues me shkrimin e deputetit Hil Mosi i titulluar “Forma e regjimit”.

Hafiz Dalliu i ka hapur faqet e kësaj gazete për debatet pro e kundra. Dallohet qartë opozitarizmi ndaj qeverisë në fuqi, gjë që do ta shoqëronte gjatë të gjithë jetës atë. Ai nuk është pajtuar ndonjë herë me këdo regjim, duke ecur me idenë e mbrojtjes së

të dobtëve dhe duke u kthyer kështu në zëdhënësin e tyre.

Një vend të veçantë në faqet e gazetës së tij ka zënë edhe Çështja Kombëtare, si një problem shqetësues i ditës për të gjithë opinionin e gjerë. Vuajtjet dhe përndjekjet e Çamërisë trajtohen gjerësisht në këtë gazetë, po ashtu edhe shkatërrimet e regjimit serbo-malazez në Kosovë. Gjithashtu edhe lajme të shkurtra mund të gjehen rreth problemeve të Çamëve në faqet e tjera të kësaj gazete. Kjo tregon ndjeshmërinë e lartë jo vetëm të botuesit të kësaj gazete për këtë çështje, por edhe ndjeshmërinë e publikut. Me statistika të posaçme nën okelion “Shkurtimi i mixorive serbe në Kosovë” (15 tetor 1918- 1 qershor 1921) jepen të dhëna të hollësishme mbi shkatërrimet e shtëpive, vrasjet dhe burgosjet e bëra nga pushteti serb në 10 qytete të Kosovës, si Prizreni, Gjakova, Peja, Mitrovica etj.

Kështu mund të themi se tendenca e H. Dalliu ka qenë që në faqet e kësaj gazete të trajtojnë me të gjitha mundësitë problemet shqetësuese të kohës, duke bërë këtë gazetë të mos dallojë për nga simotrat e kohës, si dhe nga reagimet ta verë atë në qendër të vëmendjes së publikut. Na duhet të shohim me mirëkuptim vështirësitë e mëdha në të cilat kalonte shtypi në këtë periudhë, kur shtypshkronjat ishin të pakta dhe me probleme personeli.

Ai i ka bërë reklamë edhe fluturimit të parë të brendshëm me aeroplanë, postës me aeroplan dhe fluturimit të parë të linjës Tiranë-Shkodër më 1.VI. 1925, si dhe edicionit të një zarfi me pulla të posaçëm për këtë ngjarje.

Në faqet e kësaj gazete kanë shkruar përveç H. Dalliu edhe shumë figura të tjera të shquara si: Aleksandër Xhuvani, Avni Rustemi, H. Jusuf Banka, Haki Stërmilli, Mehdi Frashëri, Hil Mosi, H. Ali Kraja, dr. Behxhet Shapati etj., pak a shumë numri i autorëve, të cilët kanë milituar në faqet e kësaj gazete arrin në 178. Nga numri 90 deri 94 i është bashkëngjitur drejtimin të gazetës si redaktor shkrimtari Namik Selim Delvina.

Pra, nga të gjitha sa u tha më sipër vërehet se Hafiz Dalliu ka bërë një punë titanike në nxjerrjen e kësaj gazete i vetëm. Ai është përpjekur të sillte një zë të ri në kuadrin mediatik të kohës dhe ia ka dalë, duke thyer kështu konceptet e gabuara dhe paragjykimet ndaj hoxhallarëve. Ai e shkriu personalitetin e vet dhe aftësitë e tij në shërbim të shoqërisë shqiptare dhe të atdheut. Me përpjekjet e tij të pareshtura është shembulli i shquar i një qytetari model dhe i fetarit që përpiqet për të mirën e përgjithshme, duke mos u kursyer aspak. Kohët kur ai jetoi ishin tejet të vështira, ngritja e Shtetit Independent, Monarkia, Lufta II Botërore me pushtimin italian dhe gjermanët, e më pas regjimi komunist, i cili shkatërroi çdo ëndërr për të cilën kishte luftuar Rilindasi plak. Gjithsesi ai ka lënë një trashëgimi të pasur jo vetëm me këtë gazetë, por edhe me librat fetarë të përkthyer, si dhe një trashëgimi të pasur edhe në vargje. Për jetën e tij është folur dhe do të flitet, sepse përbën modelin e përkryer të një intelektualit dhe politikani patriot.

Njoftime / “Familja dhe mësim-besimi” mbledh në një tryezë të përbashkët shoqatat muslimane



Pas një përpjekje një mujore me nismën e Forumit Musliman të Shqipërisë u realizua një tryezë e rrumbullakët ndërmjet shoqatave muslimane me temën “Familja dhe mësim-besimi”. Pjesëmarrja e shoqatave në këtë tryezë ishte maksimale dhe ishte vlerësuar seriozisht nga organizatori dhe të gjithë pjesëmarrësit. Përpara fillimit të bisedimeve, e cila ishte konceptuar për të përthithur mendimet dhe sugjerimet e të gjithë të pranishmëve u lexua deklarata e FMSH-së: “Figurat e shquara muslimane

dhe 100-vjetori i Shtetit Shqiptar”, e cila u mirëprit nga të pranishmit dhe të gjithë ata e mbështetën këtë deklaratë. Takimi u moderua nga sekretari i FMSH-së Roald Hysa, i cili i njoftoi të pranishmit, se FMSH ka nisur me këtë deklaratë njëkohësisht edhe një fushatë sensibilizuese mediatike për figurat e shquara muslimane me kontribute të mëdha për shtetin shqiptar dhe shoqërinë. Në këtë tryezë u sollën mendime dhe sugjerime të vlefshme rreth kësaj teme. Diskutimet u bënë më

të vlefshme pas ndërhyrjeve të didaktit Xhemal Balla, i cili solli në këtë tryezë përvojën e tij të gjatë në arsim. Po ashtu edhe ndërhyrjet e z. Bedri Telegrafi ishin tepër të vlefshme, sidomos në drejtim të partnershipit të përbashkët. Kryetari i FMSH-së Fisnik Kruja vërejti se përpjekjet e përbashkëta do të sillnin rezultate të vlefshme për këtë temë, e veçanërisht në drejtim të mësim-besimit, ku nevojiten tekste, programe e një platformë e qartë veprimi. Mehdi Gurra solli në këtë tryezë një seri tekstesh për mësim-besimin që nisin nga klasa e parë e deri në klasën e 11, të cilat përdoren në shkollat e Bosnje-Hercegovinës në kuadrin e përthithjes së përvojës nga ky vend. Po ashtu edhe nga të pranishmit u sollën informacione të ndryshme nga kjo fushë, gjë për të cilën u diskutua gjerësisht. Konferencat virtuale on-line nëpërmjet internetit ishin një tjetër mundësi, e cila u propozua nga Indrit Abdij. Të gjitha subjektet e pranishme shprehën njëzëri sugjerimin, se kjo tryezë duhet të vazhdojë edhe më tej dhe kjo në nivel specialistësh të fushës përkatëse.

“Familja dhe Mësim-besimi” ishte përsëri në qendër të vëmendjes së shoqatave, që janë aktive në shoqërinë

civile muslimane. Në këtë tryezë të dytë u paraqit për diskutim drafti “Mbi nevojën e përfshirjes së mësim-besimit në kurrikulat e shkollave publike të arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”, i përpiluar nga një grup pune ad hoc. Drafti i paraqitur përbëhet nga tre kapituj kryesorë:

1. Përse Mësim-Besimi?

2. Shembulli i marrëdhënieve fe-shtet dhe mësim-besimi në ciklin parauniversitar në disa vende të Evropës dhe të Ballkanit

3. Garancitë ligjore

Pjesëmarrësit në këtë takim të dytë diskutuan gjerësisht mbi subjektin e draftit dhe e miratuan në përgjithësi atë, dhanë sugjerimet e tyre për përmirësimin e mëtejshëm të tij. Gjithashtu u propozua, që procesit të instalimit të mësim-besimit në vend, ti jepet forma e një debati publik të gjerë, në mënyrë që të parapërgatitet opinioni dhe faktorët relevantë për nevojën dhe dobinë e kësaj ndërmarrjeje.

Në këto takime përfaqësuesit e shoqatave sollën përvojat dhe propozimet e tyre rreth problemeve të cilat u trajtuan me imtësi. Në këto dy takime ishte i pranishëm si përfaqësues i LSHS, kryetari i saj hoxhë Justinian Topulli.

Kontributi i hoxhallarëve në shoqëri



“Kontributi i hoxhallarëve në shoqëri” ishte tema kryesore e takimit të organizuar nga hoxha i nderuar Mazllam Mazllami në Prizren me rastin e 25 vjetorit të fillimit të punës së tij si imam në një nga xhamitë e Prizrenit. Me këtë rast ishin ftuar dhe merrnin pjesë 400 të ftuar nga të gjitha trevat shqiptare, ku 200 prej tyre ishin hoxhallarë dhe imamë. Kjo mbrëmje u bë e këndshme nga ligjëratat e përgatitura enkas nga folësit që e morën fjalën me ligjëratat e tyre të përgatitura për këtë temë. Tubimin e përshëndeti i pari kryetari i BIK për Prizrenin Lutfi efendi Ballëk, i cili shprehu kënaqësinë e tij për realizimin e këtij tubimi, si dhe i shprehu dëshirën e mirë hoxhë Mazllamit për një punë të vlefshme edhe në të ardhme atij. Në këtë tubim përshëndetën edhe dy hoxhallarë veteranë dhe me kontribute për muslimanët në Kosovë, mulla Jetish Bajrami dhe hafiz Idriz Dërmaku. Mulla Jetish Bajrami, ish-kryetar i BIK solli kujtimet e tij nga vështirësitë e hasura në fillim të karrierës, kohë kur pushtuesit serbo-malazezë kërkonin ta dëmtonin

e ta shkatërronin me çdo kusht fenë. Dy hoxhallarë nga Shkupi dr. Zekerija Bajrami dhe Sabahudin Mahmudi folën gjerësisht përreth kësaj teme. Po ashtu në këtë takim ishin të pranishëm edhe politikanë vendorë e deputetët dr. Gëzim Kelmendi e dr. Ferid Agani, ku ky i fundit përshëndeti tubimin dhe në fjalën e tij ai vërejti rëndësinë e këtij tubimi mbarëkombëtar. Ndërkaq të pranishëm në këtë takim ishte edhe një delegacion me 50 hoxhallarë nga Lidhja e Hoxhallarëve e Shqipërisë, së bashku me kryetarin Justinian Topullin. Në këtë tubim e mori fjalën dhe përshëndeti në emër të LSHS hoxhë Mustafa Tërniqi, i cili në fjalën e tij theksoi se bashkimi për punë të mira shkon në dobi të davetit. Të gjithë të ftuarit i përshëndeti hoxhë Mazllam Mazllami, i cili njëkohësisht është edhe anëtar nderi i LSHS-së, duke iu uruar mirëseardhjen të pranishmëve dhe solli në këtë tubim madhështor kujtime nga puna e tij. Në fund të këtij tubimi madhështor në momentet e largimit iu dhurua nga një set librash.

Bota reagoi ashpër ndaj deklaratave të Esadit

Opozitarët sirianë kanë njoftuar për përleshje të forta mes kryengritësve dhe forcave ushtarake besnike të regjimit të Damaskut nëpër të gjithë vendin vetëm disa orë para mbajtjes së fjalimit nga presidentit Bashar Assad. Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut deklaroi se kryengritësit të cilët po luftojnë për rrëzimin e regjimit të Assadit kanë pasur përplasje të ashpra me trupat besnike të këtij të fundit në provincën jugore siriane Dera, rajoni i shpërthimit të revoltave popullore në marsin e vitit 2011. Dhuna po ashtu ka përfshirë edhe rajonet kryengritëse përreth Damaskut gjatë orëve të para të ditës së sotme, ku kundërshtarët e regjimit po përpiqen të çajin barrierat e rënda mbrojtëse të ushtrisë qeveritare për të hyrë në kryeqytet. Bota reagoi ashpër ndaj Beshar Esadit, i cili krahas masakrimit të 60 mijë personave nga ana e ushtrisë siriane pa bërë dallim gra e fëmijë, ende këmbëngul të mbetet në pushtet. Shoqëria ndërkombëtare fjalimin e tij e cilësoi si “manovër për të ftuar në kohë” dhe kërkoi dorëheqjen e tij. Departamenti amerikan për Marrëdhënie me Jashtë,

dhe se gjatë bërjes së thirrjeve të Esadit për dialog njëkohësisht vazhdojnë edhe masakrat nëpër qytete. Nullënd tha se plani i Esadit hodhi hije mbi përpjekjet e El Ahdar El Ibrahim, përfaqësuesit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara dhe Lidhjes Arabe për Sirinë dhe përsëriti thirrjen e bërë Esadit për tu larguar nga pushteti. Ndërkaq edhe Bashkimi Evropian reagoi ashpër kundër deklaratave të Esadit dhe deklaroi që pa largimin e tij nga pushteti nuk mund të zgjidhet kriza në Siri. Një reagim tjetër ndaj deklaratave të Esadit erdhi edhe nga opozita siriane. Këshilli Kombëtar i Sirisë deklaroi se pa largimin e Esadit nga pushteti opozita e Sirisë nuk do të pranojë asnjë iniciativë të propozuar. Ndërsa media amerikane, e cila fjalimin e Esadit e cilësoi si një sfidë, deklaroi se Përfaqësuesi i Posaçëm i OKB-së, Ibrahim do të mund të jape dorëheqje për shkak të këtyre deklaratave. Përkrahje e vetme deklaratave të Esadit të cilat tregojnë se do të vazhdohet me masakra erdhi prej Iranit. Ministri i Jashtëm i Iranit, Ali Ekber Salih i tha se “Udhëheqja e Iranit përkrah planin e propozuar”.

planin paqësor të Esadit e cilësoi si “joreale” dhe si “një përpjekje të regjimit për të mbetur në pushtet”. Zëdhënësjja e Departamentit amerikan për Marrëdhënie me Jashtë, Viktoria Nullënd (Victoria Nulland) tërhoqi vëmendjen që populli sirian është duke u torturuar për dy vjet



Roli i parimeve Islame në ruajtjen e pasurisë publike

Parimet Islame luajnë një rol tejet të rëndësishëm në jetën sociale dhe ekonomike të njeriut dhe të shtetit. Dr. Jusuf Ibrahim, drejtor i qendrës “Al Kamil” për Ekonominë Islame konfirmon se Islami i dënon krimet e korrupsionit dhe shpërdorimit të pasurisë publike, duke e konsideruar ngrënien e pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë një gjynah dhe cënim të drejtave të tjerëve, siç thotë Allahu i Lartësuar: “Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me te (me rryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë po e hani atë).” (Bekare; 188). Gjithashtu Islami e ka ndaluar monopolin duke e konsideruar një prej krimeve ekonomike, që kanë pasoja të rënda për shoqërinë, duke shfrytëzuar nevojën e njerëzve për një produkt të caktuar dhe duke komanduar çmimin e tij, me qëllimin për të realizuar një pasurim të shpejtë të një grupi njerëzish. I Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Kush mban monopolin është gabimtar.” (Muslimi).

Gjithashtu Islami e ka ndaluar mitëmarrjen, e cila sjell pasoja shkatërrimtare për shoqërinë, sepse rrënjës së padrejtësinë, shtypjen e të drejtave dhe përmbyset. Një nga format e korrupsionit që lufton Islami është edhe mashtrimi i të gjitha formave, sidomos mashtrimin në tregti, që konsiderohet një nga format e fitimit të pamërituar dhe të paligjshëm.

Dr. Ibrahim kërkon që ekonomia islame të zbatohet sipas dispozitave të nxjerra nga legjislacioni islam në Kuranin Famëllartë, duke e konsideruar këtë mënyrë, si të vetmen rrugë për t'i dhënë fund formave të korrupsionit, që është përhapur në shoqëritë tona. Në këtë mënyrë parimet islame do të kenë ndikimin e tyre në rritjen e prodhimit në sasi dhe cilësi përmes eliminimit të formave të ndryshme të korrupsionit.

ADMINISTRIMI I PASURISË PUBLIKE

Dr. Abdulfetah Idrisi, profesor i Fikhut Krahasues në fakultetin e Jurisprudencës Islame dhe Juridikut në Kajro shprehet se krimet e korrupsionit dhe shpërdorimit të pasurisë publike janë përhapur së tepërmi në shoqëritë arabe. Kjo ka ardhur si pasojë e distancimit prej parimeve islame, të cilat bëjnë thirrje për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë së muslimanëve, duke e vënë theksin në faktin, se administratori i pasurisë publike e di fare mirë, se nuk i është dhënë leja që të veprojë si të dëshirojë dhe në mënyrë të padrejtë me pasurinë publike, dhe se e ka për detyrë të jetë i ndërgjegjshëm për rrezikshmërinë që paraqet administrimi i pasurisë publike, dhe se është përgjegjës, dhe do të vihet para llogarisë sipas normave dhe kushteve që ka vënë legjislacioni islam. Si të tilla ato duhet të respektohen, kur pasuria publike shpenzohet për projekte dhe qëllime të ndryshme. Për diçka të tillë bën thirrje Allahu i Lartësuar kur thotë: “Asnjë peygamberi nuk i takoi të bëjë hile dhe kush bën hile (në ndarjen e plaçkës së luftës), ai në Ditën e Kijametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë, pastaj secilit

njeri i jepet ajo që e ka fituar, duke mos iu bërë e padrejtë.” (Ali Imran; 168).

Në traditën profetike janë përcjellë hadithe që nxisin për të ruajtur pasurinë publike dhe për ta mbrojtur atë nga shpërdorimi. I Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Kthejeni perin dhe gjilpërën, sepse mashtrimi do të jetë turp, zjarr dhe poshtërim Ditën e Gjykimit.” Ky hadith kërkon që njeriu të kthejë gjithçka ka marrë nga pasuria publike, edhe nëse vlera e saj është e vogël sa vlera e një peri dhe gjilpëre.

Dr. Idrisi vë në dukje faktin se halifët e drejtë ishin një shembull i mirë për ruajtjen e pasurisë publike dhe për mosshpërdorimin e saj për çdo arsye qoftë. Një nga mëkëmbësit i shkruajti Omer bin Abdul Azizit r.a., ku i kërkonte më shumë letra dhe kalema për të shkruajtur dhe Omeri iu përgjigj: “Mprehe mirë lapsin tënd dhe afroji rreshtat me njëri-tjetrin, sepse mua nuk më pëlqen që të shpenzoj nga pasuria e muslimanëve për gjëra që nuk u bëjnë dobi. Muslimanëve nuk u bëjnë dobi fjalët e tepërta që e dëmtojnë arkën e pasurive të tyre.”

Kur një mëkëmbës kërkoi prej tij më tepër qirinj për të ndriçuar vilajetin e tij për hatër të prijësit, kur shkante në xhami në mëngjes dhe mbrëmje, Omeri iu shkruajti: “O Ibn Umu Hazm! Përpara se të bëheshe prijës isha mësuar të të shihja duke dalë natën në errësirë pa mbajtur me vete një kandil. Pasha jetën, atëherë ke qenë më i mirë sesa sot.”

DËNIMI I ATYRE QË BËJNË PRISHJE DHE SHKATËRRIME MBI TOKË

Shejhu i nderuar Ferhat Menxhiu, një nga dijetarët e Ez'herit e vë theksin tek fakti se Allahu i Lartësuar ka përcaktuar ndëshkime për ata që bëjnë trazira mbi tokë, në mënyrë që të mbrohet shoqëria dhe të mbrohet rendi i saj. Ai shton se i Dërguari i Allahut a.s. na ka urdhëruar që ta ruajmë pasurinë publike dhe të mos e shpërdorjmë atë. Nga Adij bin Umejrete el Kendiu r.a. na përcillet, se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Atij që i ngarkojmë një punë prej jush dhe pastaj na fsheh një gjilpërë e sipër, ky është një mashtrim që do t'i shfaqet Ditën e Gjykimit.” Një burrë me ngjyrë të zezë nga mesi i ensarëve – të cilin e mbaj mend sikur po e shoh tani- u ngrit dhe tha: -“O i Dërguari i Allahut! Pranoje dorëheqjen time nga punët që më ke ngarkuar.” Profeti a.s. tha: “Pse, çfarë ke?” Tha: “Dëgjova që the kështu dhe ashtu.” Profeti a.s. tha: “Unë po e them tani. Atë që e ngarkojmë me një punë le ta sjellë gjithçka të vogël apo të madhe qoftë, e nëse i japin diçka prej saj le ta marrë dhe nëse ia ndalojnë, të mos e marrë asgjë.” (Muslimi)

Ky hadith na tregon se nëpunësi publik është i detyruar t'i përmbahet disa normave fetare dhe se nuk e ka të drejtën, që të shpenzojë vetëm atë pasuri për të cilën i jepet leje dhe të mos marrë apo të japë diçka prej saj, por nëse merr diçka prej saj, atëherë duhet ta kthejë përsëri në vendin e vet. Gjithashtu ky hadith bën të qartë, se për të luftuar korrupsionin shteti duhet të ndërmarrë disa masa të rëndësishme, ku ndër më të rëndësishmet është kërkesa e llogarisë prej

nëpunësit, sidomos e atyre nëpunësve, që kanë shenja të pasurimit të madh dhe të shpejtë. Ndoshta ky parim ishte ndër parimet më kryesore mbi të cilin u ngrit shteti i parë islam. Një arab qëndroi para Omerit r.a. dhe i tha: “As nuk të dëgjoj dhe as nuk të bindem. Nga e more këtë rrobë të gjatë? I ke dhënë nëpunësve nga arka e muslimanëve disa rroba, që nuk mjaftojnë për t'u mbuluar.”

Omeri r.a. i dha përgjigje dhe tha se kishte marrë nga rrobat, që i takonin të birit. Pastaj tha: “Nuk do të ketë hajër prej jush nëse nuk i thonë këto fjalë dhe nuk ka hajër prej nesh nëse nuk i dëgjojmë ato.”

LUFTA NDAJ KORRUPSIONI I SHPËTON POPUJT

Dr. Muadh Abdullah, profesor në fakultetin e Bazave të Fesë në Universitetin e Ez'herit, shprehet, se lufta ndaj korrupsionit përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm për të larguar ndëshkimin e Allahut mbi popujt. Argument për këtë është fjala e Allahut a.s.: “E përse të mos ketë pasur në brezat që ishin para jush njerëz të zotët e mendjes e të nderit, që të ndalonin çrregullimin e kaosin në tokë, përveç një pakice, të cilët i shpëtuan (ngase frenuan nga të këqijat), ndërsa ata që ishin mizorë u dhanë pas kënaqësive si të shfrenuar, duke vazhduar të jenë mëkatarë.” (Hud, 116).

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu nuk i prish vendbanimet padrejtësisht, kur banorët e atyre (vendbanimeve) janë vepërmirë.” (Hud; 117).

Profesori mendon se jo vetëm që do t'i shpëtojnë popujt prej ndëshkimit të Allahut, por do t'i nxisë ata për të shkuar drejt përparimit dhe zhvillimit. Pra në vend që milionat të shkojnë në xhepat e njerëzve të prishur, që marrin rryshfete, ato do të shkojnë në projekte të dobishme, që sigurojnë vende pune dhe që sherojnë burimet e varfërisë dhe papunësisë.

Nga ana tjetër lufta ndaj korrupsionit nuk bëhet vetëm me ligj dhe këshilla, por duhen vënë në jetë parimi i madh islam “nga të erdhi kjo”. Gjithashtu duhet të përhapet drejtësia dhe solidariteti mes individëve të shoqërisë. E gjitha kjo do të bëjë që të ndalohet rryshfeti dhe diskriminimi dhe të gjitha format e korrupsionit, që janë të lidhura me mungesën e drejtësisë sociale. Për diçka të tillë flet hadithi i përcjellë nga Muadhi r.a., që thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. më dërgoi në Jemen. Kur u nisa ai më dërgoi dikë për të më thirrur dhe unë u ktheva. Ai më tha: “A e di përse të thirra?! Nëse dikush merr diçka pa lejen time ai ka mashtruar dhe kush mashtron do të paraqitet Ditën e Gjykimit me gjithë mallin që ka përfutur. Për këtë të thirra dhe tani vazhdo punën tënde.”

Ky hadith tregon se është e ndaluar të përfitohet nga pasuria publike pa marrë leje, sepse në këtë mënyrë ai ka vepruar me pasurinë e Allahut padrejtësisht. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Ata që veprojnë me pasurinë e Allahut padrejtësisht do të kenë zjarrin Ditën e Gjykimit.” (Buhariu).

Jerusalem - sulmohen xhamitë dhe trashëgimia osmane



Grupe radikale çifute kanë shkatërruar Xhaminë e Profetit Daut dhe vepra të periudhës osmane në pjesën e vjetër të qytetit ku gjenden vendet e shenjta për të tre fetë hyjnore. Izraeli vazhdon të mos tregojë sensibilitetin e duhur për mbrojtjen e veprave islame në tokat e shenjta që i mban të pushtuara për rreth gjysmëshekulli. Grupet radikale çifute këtë herë morën në shënjestër Xhaminë e Profetit Daut në lagjen e vjetër të Jerusalemit. Në deklaratën e lëshuar nga Fondacioni El-Aksa dhe Agjencia e Mbrojtjes Kulturore thuhet se grupet radikale çifute sulmuan xhaminë e Profetit Daut, që ndodhet në pjesën jugperëndim të Mesxhid-i Aksa dhe shkaktuan dëme të rëndësishme në avllinë e xhamisë. Gjithashtu në këtë sulm agresorët kanë shkatërruar edhe pllakat e mermerit dhe fajancat e kohës osmane të shekullit të 17-të që ndodheshin në tre muret e xhamisë. Kurse më herët Izraeli një pjesë të Xhamisë së Profetit Daut e kishte shndërruar në sinagog, pavarësisht se ajo ishte një prej veprave më të rëndësishme të historisë islame. Grupet palestineze thonë se kjo nuk është hera e parë që një xhami historike sulmohet nga grupet ekstreme izraelite.

Identitetet përthyeset e mesazhit


Nga Gazmend Leçini

1. Dialog jo Monolog

Shpesh na krijohet përshtypja se “të komunikosh” do të thotë thjesht t’i përcjellësh, apo transferosh dikujt a disave një mesazh, apo informacion me mënyra dhe mjete të ndryshme, qofshin këto mjete komunikimi individuale apo masive. Në fakt kjo përshtypje ka mbizotëruar për një kohë të gjatë në teorinë e komunikimit, ku thelbi është që dhënësi përcjell një informacion me anë të një kanali komunikimi dhe marrësi automatikisht e ka përvetësuar këtë informacion. Kjo teori ka një mangësi reale dhe lehtësisht të konstatueshme. Këtë na e vë në dukje përkufizimi më i fundit i bërë nga Gary E. Schvarts, ku thotë: “Komunikimi përbën ndarjen ose shkëmbimin e mendimeve, opinioneve ose informacionit nëpërmjet fjalës, shkrimit apo shenjave”.

Ajo që e bën dallimin në këtë përkufizim është përdorimi i termit, “ndarje” dhe “shkëmbim” në ndryshim me termin “përcjellje” apo “transferim”. Me fjalë të tjera kjo do të thotë se procesi i komunikimit apo i “të marrurit vesh” nuk mbaron thjesht me “transferimin” e informacionit apo mesazhit pa u siguruar që ky mesazh është kuptuar dhe përthithur nga marrësi. Këtë e kuptojmë pikërisht nga “shkëmbimi” i mesazheve të marrësit me dhënësin. Reagimi i marrësit është treguesi më i mirë se sa apo si është kuptuar mesazhi. Ky është pikërisht feedback-u, aq i rëndësishëm për një komunikim normal. Autorë të ndryshëm të komunikimit i mëshojnë shumë faktit se për të pasur shkëmbim real të dhënash duhet të evitohen disa probleme që lidhen së pari me dhënësin e mesazhit, nga ku dhe buron komunikimi. Në një nga përkufizimet e komunikimit lexojmë: “Komunikimi është procesi simbolik gjatë të cilit kuptimi ndahet negocihet. Me fjalë të tjera, komunikimi ndodh sa herë që dikush i jep kuptim fjalëve ose veprimeve të dikujt tjetër”.

Profesor Artan Fuga na njeht me disa nga këto problematika shumë domethënëse. Ai thotë: “Tjetri konsiderohet si një qenie e huaj me të cilin mund të dialogohet vetëm për t’i diktuar mendimin tënd dhe jo për të hyrë në bashkëbisedim të frytshëm me të.” Thënë ndryshe ne kur komunikojmë me dikë qysh në gjenezë e kemi të përcatuar qëllimin e bisedës, vetëm do të jap e nuk do të marr asgjë. Jo vetëm kaq por dhe në rastin kur ne kemi për qëllim realisht të marrim një mendim apo mesazh nga dikush, këtë dikushin e zgjedhim pikërisht nga ata individë që ndajnë të njëjtin mendim si i yni, pra nuk kemi dëshirë të dëgjojmë se çfarë mendon dikush për një çështje të caktuar, por duam të dëgjojmë se ç’mendojmë ne vetë nga goja e tjetrit. Me të drejtë z. Fuga këtë e quan “autizëm social”, sepse nuk ka shkëmbim mesazhesh por thjesht imponim mendimi dhe riciklim i asaj që ne mendojmë pa pasur dëshirë të dëgjojmë realisht mendimin e tjetrit, edhe nëse është i ndryshëm me mendimin tonë. Shprehja “Njih vetveten” duhet zëvendësuar me shprehjen “Njih vetveten



nëpërmjet tjetrit”.

Të njëjtin qëndrim e hasim dhe tek Mounier: “Të kuptosh, do të thotë të reshtësh së qëndruari në këndvështrimin vetjak, për t’u vendosur në këndvështrimin e të tjerëve; por nuk duhet ta kërkoj vetveten tek një tjetër i ngjashëm me veten.” Njeriu ka nevojë jo vetëm të dëgjojë por edhe të dëgjohej kur shprehet siç thotë dhe Mounier: “E dhëna fillestare e përvojës, tek komunikimi, nuk është gjendja më e mundshme ose më universale, por akti përmes gjej veten duke u shprehur.”

Fatkeqësisht dialogu është zëvendësuar me Monolog, të tipit pyes dhe dëgjoj vetëm atë që mendon si unë, pra dëgjoj vetveten. Kjo epidemi është një trashëgimi e keqe e sistemit komunist, që vazhdon të jetë aktuale. Zyrtarët e kohës merrnin thjesht urdhra nga eprorët e tyre nën parrullën “ligji zbatohet nuk diskutohet” dhe këtë frustrim e shkarkonin dhe tek vartësit e tyre, pa marrë aspak parasysh se çfarë mendonte zbatuesi, edhe nëse mund të kishte një ide më të mirë për realizimin e diçkaje. Mungesa e këtij dialogu real mendoj se ndodh fatkeqësisht dhe për një arsye tjetër, paafësia e dikujt për t’u përballur me mendimin alternativ. Kjo e bën që t’i presë rrugën mendimit të ndryshëm nga ai i veti që e mendon si e vërteta absolute që nuk pranohet diskutim. Zgjidhja duhet të jetë aftësimi për të mbrojtur me argumente bindëse mendimin tënd dhe hapja ndaj mendimit të tjetrit, se “ndonjëherë dhe tjetri mund të ketë të drejtë”.

2- Njih Identitetet e bashkëbiseduesit

Problemi tjetër po aq i rëndësishëm që ndikon në një mungesë të komunikimit real është dhe mosnjohja e tjetrit. Duhet të kemi parasysh se ajo që ne përçojmë kalon nëpër disa filtra dhe përthihet nga disa prizma këndvështrimesh të ndryshme nga ato të dhënësit. Njohja e tjetrit është detyrë parësore para se të mendojmë për të hyrë në raporte komunikimi me të, ndaj “kur ne komunikojmë, supozojmë që personi tjetër merr kuptimin që ne duam që ai të marrë”, pra të komunikosh do të thotë të marrësh parasysh dhe se si mund ta ketë kuptuar ai mesazhin tënd, fundja personi përballë nesh do të reagojë ndaj mesazhit tonë ashtu si e ka kuptuar ai e jo nga ajo që ne kemi dashur të themi, që mund të jetë e ndryshme nga konceptimi i bashkëbiseduesit. Duhet përdorur shpesh shprehja “çfarë mendoni se doja të thoja?” Në fakt koncepti i identitetit është më i gjerë se ç’e mendojmë. Nuk ka të bëjë thjesht me disa përkatësi të ngurta dhe të

njëta. P.sh duket se kur flet për identitetin e shqiptarëve, të krijohet përshtypja se në mos të gjithë, të paktën një pjesë e madhe e tyre, janë të ngjashëm. Referuar një autori libanez, Amin Maalouf, kjo nuk është e saktë, sepse “identiteti i dikujt përcaktohet dhe nga shumë elementë të tjerë si, përkatësia fetare, një grup etnik a gjuhësor, profesioni, grupi social, bindjet politike, preferenca të ndryshme, një familje pak a shumë e madhe, nga rajoni nga vjen etj. Të gjitha përkatësitë kanë rëndësinë e tyre, por jo në të njëjtën kohë. Asnjëra në veçanti nuk e përmbush identitetin e dikujt”.

Sa më shumë të marrim nga kultura e tjetrit, aq më shumë mund t’i japim atij nga e jona. Gjithashtu duhet të dimë se sa më shumë respekt që të ndiejmë për të tjerët dhe përkatësitë e tyre, aq më të hapur do të jenë ata ndaj bindjeve tona. Të mos harrojmë se e drejta për të kritikuar tjetrin fitohet me reciprocitet. Një koncept interesant në lidhje me identitetet është dhe fakti se një bindje e modifikon një grup të caktuar njerëzish po aq sa dhe ky grup njerëzish e modifikon një qëndrim të caktuar. Kjo shpjegon dhe faktin se sjelljet e njerëzve nuk varen totalisht vetëm nga një ide a bindje, por ajo modifikohet dhe nga tërësitë e tjera që përbëjnë këtë individ a grup shoqëror. Kur ne bisedojmë me një kategori të caktuar njerëzish që në disa përkatësi janë të ndryshëm nga ne, nuk duhet të harrojmë se natyra njerëzore është e gatuar në atë mënyrë që jo gjithmonë mund ta pranojë atë që i përcillet në bisedë. Ndaj dhe duhet ta kemi të parapërgatitur ndjesinë e refuzimit. Është e rëndësishme të merret në konsideratë thënia e Marc Block se “Njerëzit janë më tepër bij të kohës se të baballarëve të tyre”. Kjo do të thotë se njeriu padyshim është produkt i shoqërisë me të cilën ndan një pjesë të mirë të kohës së tij. Çdokush ruan dy përkatësi, atë “vertikale” që vjen nga paraardhësit e tij, nga traditat e vendit ku është rritur, e kjo padyshim që lë gjurmë të thella në personalitetin e dikujt, gjurmë të cilat do të ndikojnë në sjelljet e tij të mëvonshme. Ndërsa përkatësia tjetër është ajo “horizontale” e cila e ka burimin tek njerëzit me të cilët shoqërohemi, statuset e tyre morale apo intelektuale, e kjo rritet dita ditës dhe është më përcaktuesja.

3- Diversiteti Kulturor është vlerë

Do të doja të ndalesha pak dhe në dy koncepte të tjerë që Amin Maalouf i mëshon fort. Ato janë “Universaliteti”

dhe “Uniformiteti”. Duken si të njëjta në pamje të parë, por janë shumë larg njëra-tjetrës. Universaliteti ka të bëjë me disa parime dhe të drejta, që duhet të prekin këdo kudo që jeton. Siç është rasti i të jetuarit me dinjitet njerëzor si për një evropian ashtu dhe për një aziatik. Pra jeta e njeriut është e barazvlefshme si për një të pasur, po ashtu edhe për një të varfër. Ky është universaliteti për të cilin duhet të punojmë.

Koncepti tjetër i cili duhet njohur mirë është ai i “Uniformitetit”. Me të drejtë mund të themi se dekadat e fundit do të mbahen mend për këtë sëmundje, e cila ka për qëllim t’i fusë njerëzit të gjithë në një kallëp. Të gjithë duhet të vishen njëllor, duhet të përdorin të njëjtat shprehje gjuhësore, të shohin të njëjtat emisione, komenti mbi ngjarjet është i njëjtë, ushqimi pothuajse po unifikohej. Por ajo që është më e rrezikshmja, është dëshira për t’i bërë njerëzit të mendojnë të gjithë njëllor. Kjo nuk sjell asgjë më shumë se sa një varfëri intelektuale dhe një konsumim të vetvetes, nëse u mbyllet rruga atyre që nuk mendojnë si ne. Një problematikë tjetër që hasim në komunikim me njerëz të kulturave të ndryshme është dhe Etnocentrizmi, besimi se grupi kulturor i dikujt është superior ndaj të gjitha grupeve të tjera kulturore. Etnocentrizmi mund të jetë edhe ekstrem gjer në atë pikë sa dikush nuk mund ta besojë se dot, se vlerat e një kulture tjetër, janë njëllor të vlefshme ose më të mira se të tija. Ai bëhet barrierë kur i pengon njerëzit edhe nga përpjekja për të kuptuar pikpamjen e dikujt tjetër nëpërmjet “lenteve përshkruese të tij/saj”. Edhe pse në pamje të parë të mendosh njëllor siç mendojnë shumë të tjerë duket pozitive, në realitet kjo sjell një monoton foshnjarake. Nuk jemi në epokën e masave, por në atë të individit ku çdokush ka personalitetin e tij, i cili nëse nuk respektohet mbart në vetvete atë që quhet “tundimi i inatit”. Për të mos arritur në këtë pikë kërkohet që çdokush të gjejë një pikë përkatësie të asaj se çfarë mund të ofrojë ai. Kjo do të thotë se duhet hequr bindja se disa vetëm japin dhe disa të tjerë vetëm marrin. Ajo që e bën më të prekshëm këtë problem është dhe mospasja e dijes dhe bindjes fetare në nivelin e duhur. Se fundja nëse nuk pyetesh nga personat që kanë detyrimin për një çështje të caktuar për të cilën ti realisht je i informuar, apo dhe nëse pyetesh dhe përsëri nuk zbatohet mendimi yt, përsëri ju e keni larguar përgjegjësinë nga vetja juaj. Mbetet që ju të vuani pasojat e veprimtimit të gabuar në një situatë të caktuar nga ata që e kanë përgjegjësinë reale për t’u dhënë zgjidhje problemeve. Në fakt tingëllon si ngushëllim për këtë kategori njerëzish të “zhvlerësuar”, por nuk duhet të harrojmë se më i mirë është ai që rri me njerëzit dhe duron pasojat e tyre, se sa ai që shkëputet prej tyre. Fatmirësisht rrugët ku gjithsecili mund të ofrojë diçka janë të shumta.

E të shpresojnë se me prezencën dhe qëndrimet e tyre të jenë sadopak imponues për pjesën tjetër e cila kam bindjen se do të kthellohet në vlerësimin e çdokujt që është i sinqertë në kontributin që ofron.



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni,
pranë Xhamisë së Kombinatit
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat

A.-M.-B.-C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë

Cel: 0672812607 / 0672821589